



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 436 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 62, datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor të ri "Një vend i shejtë i periudhës antike në Vaun e Dejës (në aksin rrugor bregdeti i Adriatikut për në Ballkanin Qendror), 2019"*, drejtuar nga Prof.Dr. Gëzim Hoxha (IA) në bashkëpunim me Prof.Dr. Andeas Oettel (Instituti Arkeologjik i Berlinit-Gjermani), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor të ri "Një vend i shejtë i periudhës antike në Vaun e Dejës (në aksin rrugor bregdeti i Adriatikut për në Ballkanin Qendror), 2019"*, drejtuar nga Prof.Dr. Gëzim Hoxha (IA) në bashkëpunim me Prof.Dr. Andeas Oettel (Instituti Arkeologjik i Berlinit-Gjermani), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Përpilimi i një plani topografik për kodrën e vendit të shenjtë (matjet me tachimetër, fotografitë dhe filmimet ajrore do të kryhen me dron).
 - Vendosja e sondazheve në shpatin jugor të kodrës, ku është gjetur materiali sipërfaqësor: Përcaktimi i mikro-njësive dhe grumbullimi i mëtejshëm materialit arkeologjik sipërfaqësor; Gërmimi i depozitimeve të vogla të tokës, të akumuluar në gropat në shpatin e kodrës shkëmbore; Kërkimi me detektorin e metaleve mbi dheun e rrëshqitur në shpatin e kodrës, me shpresën për të gjetur monedha dhe objekte votive prej bronz.
 - Gërmime testuese në rreth 3 çarje shkëmbore në terren, për të kontrolluar nëse aty ka objekte votive të varrosura apo të hedhura në mënyrë rituale.
 - Gërmime-provë në zonat e sheshta, në pjesën veriore të kodrës, për të kontrolluar nëse vendi i shenjtë ka qenë i shtrirë deri atje.
 - Dokumentimi (vizatime, fotografi dhe përshkrime të hollësishme) i konteksteve stratigrafike dhe materialit të gjetur në vend.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

A blue ink handwritten signature of Rudina Zoto is written over the printed name.